



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së dymbëdhjetë të Komitetit për Politikë dhe Financa të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, mbajtur më 20.12.2012, e cila filloi në orën 15:00.

Në mbledhje ishin të pranishëm: Sami Hamiti, Mustafë Krasniqi, Tefik Mehmeti, Hazir Borovci, Engin Beyoglu, Aziz Pacolli, Milazim Vitia, Shemsi Veseli dhe Shefqet Sylejmani.

Në mbledhje morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive të Komunës dhe përfaqësuesit e OSBE - së.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Sami Hamiti , kryesues.

Para se të fillonin me rendin e ditës, kryesuesi propozoi që në këtë mbledhje të shqyrtohet edhe Propozimvendimi për dhënien e objektit nr. 2 të zjarrfikësve në shfrytëzim dhe menaxhim të përkohshëm NPK "Hortikultura" SH.A. Prishtinë.

Njëzëri u miratua ky

REND DITE :

- 1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së njëmbëdhjetë;**
- 2. Propozimrregullorja për menaxhimin e mbeturinave në territorin e komunës së Prishtinës;**
- 3. Propozimvendimi për vazhdimin e afatit të dhënies së pronës komunale në shfrytëzim me qira Agjencionit për Përkrahjen e Punësimit në Kosovë - APPK;**
- 4. Propozimvendimi për dhënien e strehimores publike në shfrytëzim të përkohshëm;**
- 5. Propozimvendimi për dhënien e objektit të zjarrfikësve në shfrytëzim dhe menaxhim të përkohshëm NPK "Hortikultura" SH.A. Prishtinë;**
- 6. Propozimvendimi për dhënien e pronës komunale - hapësirën e bufesë në shfrytëzim me qira;**
- 7. Propozimvendimi për caktimin e anëtarëve të Kuvendit të Komunës në komisionin për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim me qira;**
- 8. Të ndryshme.**

Pika e parë

Shefqet Sylejmani bëri vërejtje në ekstraktin e procesverbalit të mbledhjes së kaluar, duke thënë se në vend të: “procesverbaleve” duhet të jetë: “procesverbali”, por edhe kur shënohet mungesa e ndonjë këshilltari, të thuhet mungesë me arsye ose pa arsye. E njëjta duhet të vlejë edhe për drejtorët, të figurojnë emrat e tyre. Në pikën “Të ndryshme”, në vend të “verifikimit” duhet të jetë “ndarjen e pasurisë dhe verifikimin e pronës të banesave dhe lokaleve afariste në kompleksin “Dielli” ...”

Për lokacionin prapa Bibliotekës Kombëtare, të vërtetohet pronësia e më pas të bëhet ndarja. Për linjën e premtuar “Bregu i Diellit - Akademia e Shkencave - Plepa”, që është linjë më e shkurtër, kërkoi që të realizohet kërkesa dhe të plotësohet premtimi i Drejtorisë, i dalë nga vendimi i Kuvendit të Komunës. Gjithashtu, ai kërkoi edhe hapjen e pusit në kompleksin banesor “Dielli” në lagjen “Kodra e Diellit”, si dhe mirëmbajtjen e parkut ta bëjë NPK “Hortikultura”.

Kryesuesi kërkoi që kërkesat të jenë me shkrim dhe t’u dërgohen edhe drejtorive, në mënyrë që ato të kryhen.

Njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së kaluar, me vërejtjet e dhëna.

Pika e dytë

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës informoi Agim Gashi.

Tefik Mehmeti tha se në nenin 8.2, fjalia e fundit, të përcaktohet orari nga ora 22:00 deri në orën 5:00. Neni 15.1 të jetë : “Operatori ekonomik që do të merret me grumbullimin dhe përpunimin e mbeturinave, zgjidhet me procedurë ligjore sipas LPP-së së Kosovës”.

Agim Gashi paraqiti sqarime shtesë.

Shefqet Sylejmani përkrahu vërejtjet e paraqitura nga Tefik Mehmeti, dhe shtoi se ky propozim duhet të rregullohet gjuhësisht. Në nenin 1 në vend të fjalës “rregullohet” duhet të jetë “përcaktohet”, dhe të përmirësohet përdorimi i fjalës “mbeturina”, pasi që është përsëritur shumë. Te pjesa operative, kishte qenë mirë të thuhet se kjo i takon kompanive. Në nenin 4, të ceket ajo çka parashihet në nenin 10 të ligjit. Në nenin 6.6 a, duhet të kemi edhe ndonjë përshkrim tjetër të kontejnerëve, përveç ngjyrës. Neni 11.2 të qartësohet. Në nenin 12, në vend të “ të kenë qasje” të thuhet “të trajtohen”. Në nenin 12.3, në vend të “prodhuesit të mbeturinave” të jetë “krijuesi i mbeturinave”.

Aziz Pacolli përkrahu vërejtjet e dhëna. Ai tha se do të ishte mirë të thuhet: “pas orës 9, ose para orës 8”, dhe kërkoi që në nenin 19.2 të jetë më e zbërthyer çështja e dënimeve.

Milazim Vitia pyeti se si do të trajtohen materialet e rrezikshme.

Agim Gashi paraqiti sqarime shtesë dhe u përgjigj në pyetjet e parashtruara.

U konstatua se u përkrah njëzëri Propozimrregullorja për menaxhimin e mbeturinave në territorin e komunës së Prishtinës, me vërejtjet e dhëna, dhe i dërgohet Kuvendit për miratim.

Pika e tretë

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës informoi **Xhelil Bekteshi**.

Kryesuesi paraqiti sqarime shtesë.

Shefqet Sylejmani përkrahu këtë propozim, por paraqiti vërejtje në nenin 5, duke thënë se në vend të tokës duhet të jetë objekti, dhe pyeti se a është menaxhmenti i njëjtë me atë të vendimit të vitit 2010.

U konstatua se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për vazhdimin e afatit të dhënës së pronës komunale në shfrytëzim me qira Agjencionit për Përkrahjen e Punësimit në Kosovë, dhe i dërgohet Kuvendit për miratim.

Pika e katërt

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës informoi **Agim Gashi**.

Aziz Pacolli kërkoi që neni 1 të riformulohet, ose pas fjalës miraton të vihet presje.

Shefqet Sylejmani u pajtua me vërejtjen e dhënë dhe kërkoi që vendimet dhe konkluzionet e marra t’u dërgohen edhe drejtorive.

U konstatua se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për dhënien e strehimores publike në shfrytëzim të përkohshëm, me vërejtjen e dhënë, dhe i dërgohet Kuvendit për miratim.

Pika e pestë

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës informoi **kryesuesi**.

Shefqet Sylejmani pyeti se bufeja, e cila gjendet në bodrumin e ndërtesës, a i plotëson kushtet teknike për një gjë të tillë.

Aziz Pacolli tha se është për këtë propozim, por shtroi pyetjen se çka do të ndodhë me ato firma, të cilave iu është dhënë prona komunale në shfrytëzim me qira dhe iu ka skaduar afati.

Kryesuesi paraqiti sqarime shtesë dhe u përgjigj në pyetjet e shtruara.

U konstatua se njëzëri u miratua Propozimvendimi për dhënien e pronës komunale - hapësirën e bufesë në shfrytëzim me qira dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Pika e gjashtë

Përkitazi me këtë pikë të rendit të ditës informoi **kryesuesi**.

U konstatua se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për caktimin e anëtarëve të Kuvendit të Komunës në komisionin për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim me qira, dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Pika e shtatë

Arsyetimin për këtë pikë të rendit të ditës e paraqiti **Agim Gashi**.

Kryesuesi paraqiti sqarime shtesë.

Tefik Mehmeti tha se ky është një propozim shumë i mirë, por është mirë që të gjendet edhe një parcelë për kultivim, sepse në pjesën e banesave të Aeroportit mund të bëhet ndërtim i lartë. Njëherësh kërkoi që skicat ose të jenë më të qarta, ose të mos sillen fare.

Agim Gashi paraqiti sqarime shtesë.

U konstatua se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për dhënien e objektit nr. 2 të zjarrfikësve në shfrytëzim dhe menaxhim të përkohshëm NPK "Hortikultura" SH.A. Prishtinë, dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Pika e tetë

Të ndryshme

Shefqet Sylejmani kërkoi që stolisja e qytetit të vazhdojë së paku deri te Xhamia e Llapit. E njëjta vlen edhe për rrugën për Makovc, si dhe kërkoi që t'i bëhet një vizitë shkollës "Model" te ish -Tjegullorja. Ai gjithashtu kërkoi që:

1. Të tregohet kujdes në harmonizimin e titujve gjatë hartimit të materialeve të ndryshme, pra të jetë një model.
2. Të përshpejtohet puna e komisionit për ndarjen e pasurisë dhe verifikimin e pronës të banesave dhe lokaleve afariste në kompleksin "Dielli" në lagjen "Kodra e Diellit".
3. Të vërtetohet pronësia prapa Bibliotekës Kombëtare, e më pas të bëhet ndarja e saj.
4. Të realizohet premtimi i dhënë për linjën e re në trafikun urban: Kodra e Diellit - Akademia e Shkencave - Plepa, e cila vijë është më e shkurtër, me një kërkesë shtesë, që të shihet mundësia e zgjerimit të një kthese të rrugës afër shtëpisë së Veli Deves.
5. Të jetësohen kërkesat e bëra më herët për largimin e automjeteve dhe punëtorëve të krahut nga hapësira para Gjykatës së Qarkut;
6. Të bëhet ndërtimi i një terreni sportiv dhe hapja e pusit në kompleksin banesor "Dielli" në lagjen "Kodra e Diellit", dhe mirëmbajtjen e parkut ta bëjë "Hortikultura".

Ai shprehu besimin se këto premtime do të realizohen.

Kryesuesi dhe Xhelil Bektashi u përgjigjën në disa pyetje të parashtruara dhe paraqitën sqarime shtesë.

Milazim Vitia tha se vazhdimisht po ka probleme me komisionet për pranimin teknik, andaj duhet të zgjidhen personat e duhur, dhe komisioni nuk duhet të bëjë pranimin teknik aty ku nuk janë kryer punët si duhet.

Aziz Pacolli tha se projekti të Tauk-bahçja ka shkuar mirë, por duhet të caktohet një punëtor që të bëjë ruajtjen dhe mirëmbajtjen e tij.

Tefik Mehmeti tha se inspekcioni duhet të veprojë, që autobusët të hyjnë në brendësi të stacionit të autobusëve, në mënyrë që mos të ndalen në mes të rrugëve. Ai gjithashtu ceku çështjen e autobusëve që shkojnë deri te Varrezat (te varri i Bajram Kelmendit), por nuk shkojnë deri në Shkabaj.

Agim Gashi dha sqarime dhe u përgjigj në pyetjet e parashtruara.

Mbledhja mbaroi në orën 17:15.

PROCESMBAJTËSE:

Alije Gusia

KRYESUESI I KOMITETIT

Sami Hamiti, ecc. i dipl.

Faqe 5 nga 5